


**NR:005/2020**
**Nr.prot:22/20**
**Lenda nr.62419074511**

|               |                                                                                                                                                                                                                            |
|---------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Për:</b>   | -Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.T VEHA ; € EURO-GROUP SH. P.K. Brigada123, Suhareke<br>-Grup i Operatorëve Ekonomik AM GROUP SH.P.K.; AAB CONSTRUCTION SH.P.K.; Mirusha Company Sh.p.k; N.N.SH. ARDI, BRIGADA 123, 23000, |
| <b>Kopje:</b> | z.Bali Muharremaj, Kryetar Komuna Suharekë                                                                                                                                                                                 |
| <b>Nga:</b>   | Bujar Kuçi, shef i Zyrës së Prokurimit                                                                                                                                                                                     |
| <b>Lënda:</b> | <b>VENDIM</b> për kërkesën për rishqyrtim të datës: 27/02/2020                                                                                                                                                             |
| <b>Datë:</b>  | <b>28/02/2020</b>                                                                                                                                                                                                          |



Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a ) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, sipas **kërkesave për ri-shqyrtim** të datës 27.02.2020, të parashtruar nga Operatorët Ekonomik Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.T VEHA ; € EURO-GROUP SH. P.K. Brigada123, Suhareke dhe Grup i Operatorëve Ekonomik AM GROUP SH.P.K.; AAB CONSTRUCTION SH.P.K.; Mirusha Company Sh.p.k; N.N.SH. ARDI, BRIGADA 123, 23000, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Asfaltimi I rruges që lidhë fshatin Ngucat ( Rruga Bashkim Gashi )-Lagjja Zekolli), Suharekë** me Nr. të Prok: **624-19-6384-5-1-1&624-019-074-511** , nxjerr:

#### V E N D I M

- Refuzohen** kërkesat për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.T VEHA ; € EURO-GROUP SH. P.K. Brigada123, Suhareke dhe Grup i Operatorëve Ekonomik AM GROUP SH.P.K.; AAB CONSTRUCTION SH.P.K.; Mirusha Company Sh.p.k; N.N.SH. ARDI, BRIGADA 123, 23000, e datës: 27/02/2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Asfaltimi I rruges që lidhë fshatin Ngucat ( Rruga Bashkim Gashi )-Lagjja Zekolli), Suharekë me Nr. të Prok: **624-19-6384-5-1-1 & 624-019-074-511**, kundër Njoftim për Vendimin e AK –së, të datës 25.02.2020 te publikuar ne platformen elektronike.
- Vërtetohet** **NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK të publikuar me datë: 25.02.2020;**
- Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;*
- Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

## Arsyetim

Autoriteti Kontraktues Komuna Suharekë, ka shqyrtuar edhe njëher pikat e kerkuara në kërkesat për rishqyrtim të OE dhe ju informon si vijon:

-OE Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.T VEHA ; € EURO-GROUP SH. P.K. Brigada123, Suhareke , po ashtu për këtë OE në bazë të shqyrtimit të pikave që ka cekur dhe bazuar në vendimin e OSHP-së të datës 03.12.2019 i cili i ka shqyrtuar këto pika, ju informojmë se te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale/ ju mungojne deshmite e kerkuara per pajisje sipas FDT.

-Ju infomojme se Mareveshja per shfrytezimin e pajisjeve nuk eshte e specifikuar per qfare malli apo per qfar pajisje behet fjale. Prandaj AK ju informon se ne baze te mareveshjes se ofruar ju nuk keni permbushur kerkesat e FDT-se per pajisjet e kerkura. Po ashtu ju keni ofruar deshmi te palexuara dhe te njejtat nuk munde te lexohen fare dhe duke marr parasysh qe kjo qeshtje eshte trajtuar njeher (OSHP) per pajisjet, AK ju informon se si rezultat i kesaj nuk mund te krahasohen te dhenat e paisjeseve dhe mund te kete ndryshim material te ofertes, andaj ju nuk plotesoni kerkesat e FDT-se per kete pike.

-Lidhur me kerkesën për rishqyrtim të OE Grup i Operatorëve Ekonomik AM GROUP SH.P.K.; AAB CONSTRUCTION SH.P.K.; Mirusha Company Sh.p.k; N.N.SH. ARDI, BRIGADA 123, 23000, AK ju informon se ka shqyrtuar edhe njëher pikar ankimore dhe konfirmon se te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale/ Ju mungojne deshmia per Staf profesional siq eshte kerkuar me FDT. Ky pretendim ankimore eshte shqyrtuar njeher sipas vendimit te OSHP-se te dates 03.12.2019 Nr.766/19. AK siq edhe ju ka informuar me qellim te evitimit te shkeljeve ligjore dhe ne harmoni me kerkesat e nenit 72 të LPP-së ka kërkuar sqarime për staf nga ana e juaj dhe siq e keni cekur edhe ju ne sqarimin e tenderit stafi i prezntuar nga ju nuk eshte ne harmoni me LPP-në sepse dy nga inxhinierët e kanë konfirmuar se nuk janë staf i juaji për këtë projekt dhe ju deshmitë e tyre i këni prezentuar në kundërshtim me LPP-në për qka AK ju ka informuar se do ta trajtojë këtë lëndë konform LPP-së.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

---

Adresa: rr.Brigada 123, p.n 23000 Suharekë